



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE
SHKODËR

Nr. ____ prot.

Shkodër më _____.____.2025

SHPALLJE PËR KONKURRIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.581, datë 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, në Urdhrit e Kryeministrit nr.163, datë 28.8.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Statutit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër;

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër shpall konkursin për pozicionin vakant:

Specialist në sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore - Kategoria e pagës **IV-3**.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për këtë pozicion:

1. Hartimi ose bashkëpunimi me sektorët përkatës për hartimin e projekteve të restaurimit, relacioneve teknike dhe preventivave të punimeve, si dhe propozime për shpallje pasuri kulturore;

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

2. Pas përfundimit të punimeve së bashku me specialistat e punimeve bën azhurnimin e dokumentacionit dhe harton situacionin përfundimtar.
3. Mban nën kontroll situatën në lidhje me mbrojtjen, konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin ku ka juridiksion institucioni.
4. Zbatimi i detyrave të ngarkuara nga eprori;
5. Përgjigjet tek eprori për inspektimin e pasurive kulturore që janë nën juridiksionin e DRTK Shkodër.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E POSAÇME:

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
6. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
7. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor në Fakultetin e Arkitekturës ose të barasvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
2. Të ketë të paktën 1-2 vite përvojë pune në profesion;

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

3. Të ketë njohuri në gjuhën angleze; Njohuri kompjuterike në programet bazë të kompjuterit;
4. Të ketë aftësi menaxhuese, organizative, komunikuese si dhe punë në grup shumë të mira.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
- Jetëshkrim (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf pranë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër brenda datës 13.10.2025

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në DRTK Shkodër , brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **20.10.2025**, DRTK Shkodër do të shpallë në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Komisioni. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen përmes postës elektronike zyrtare e institucionit, për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin si dhe njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.581, datë 28.8.2019 “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”,

b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të testimit nga Komisioni sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të testohen dhe vlerësohen nga Komisioni pranë DRTK Shkodër sipas pikëzimit:

a) 40 (dyzet) pikë për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës;

b) 50 (pesëdhjetë) pikë për përvojën profesionale të mëparshme;

c) 10 (dhjetë) pikë për motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për pozicionin e punës:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, DRTK Shkodër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com.

Drejtori

Helidon Sokoli

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409